



Deklaratë për media
30 Mars 2007

Shërbimi i ri Informativ për Kosovën

Sot, Saferworld dhe Forumi i Iniciativës Qytetare (FIQ) publikojnë një raport të ri, *Zbulimi në Kosovë: Vështrimi përpara*. Propozimet e Kombeve të Bashkuara (KB) për statusin përfundimtar të Kosovës përfshijnë planet për krijimin e një Shërbimi të Sigurisë të Kosovës (ShSK). Raporti ka për qëllim shqyrtimin e implikimeve dhe sfidave të krijimit të ShSK-së për Kosovën dhe rajonin.

“Duke marrë parasysh situatën aktuale politike në Kosovë, njerëzit kanë nevojë të dinë se Shërbimi i Sigurisë i Kosovës do të jetë i paanshëm, apolitik dhe i përgjegjshëm. Vendimmarrësit duhet të sigurohen që i njëjti të mbroj dhe shërbej publikun e jo fraksionet kriminale ose politike,” tha Robert Parker, Drejtor për Evropë, Saferworld.

Historia e vonë e studimit autoritar u ka dhënë shumë Kosovarëve ndjenjën se shërbimet e zbulimit janë, nga natyra, një mjet i represionit ose një instrument i abuzimit i kontrolluar nga grupe të vogla interesi ose banda kriminale. Diskutimi publik për këtë çështje është i rrallë dhe kryesisht i kufizuar mbi qarkullimet e thashethemeve dhe deklarimeve mbi drejtimin e keq të shërbimeve inteligjente joformale të Kosovës.

Raporti ka për qëllim të hap një diskutim publik mbi këtë çështje. I njëjti hulumton praktikatat më të mira të zhvilluara ndërkombëtare në fushën e reformës së zbulimit dhe ofron rekomandime se si ato duhen aplikuar në Kosovë. Bashkimi Evropian (BE) është afër lansimit të misionit të tij në fund të vitit 2007 dhe do të marrë përsipër disa përgjegjësi strategjike në fushën e sigurisë dhe sundimit të ligjit. Është thelbësore që BE të përkrahë një proces më të hapur dhe më real për reformën e sektorit të sigurisë në mënyrë që Qeveria e Kosovës dhe publiku i gjerë të kenë më shumë zotërim të këtyre vendimeve kyçe.

Saferworld dhe FIQ kërkojnë nga Misioni i Përkohshëm i Administrimit të KB-së në Kosovë (UNMIK), BE-ja dhe institucionet relevante Kosovare të sigurojnë që:

- masat ligjore të sigurisë të jenë të mjaftueshme dhe të vendosura në mënyrë që të rregullohet në mënyrë efektive ShSK-ja, duke marrë parasysh kornizën ligjore komplekse të Kosovës dhe kapacitetet e kufizuara të Kuvendit të Kosovës;
- të merret një vendim i qartë nëse anëtarët e organizatave ekzistuese jozyrtare të zbulimit, mund të rekrutohen në ShSK ose duhen lënë jashtë saj;
- këshillat dhe përkrahja e donatorëve, qeverive dhe agjencive të interesuara të merren parasysh dhe të jenë të koordinuara për ndihmën e krijimit të ShSK-së;
- një konsideratë e duhur ti jepet nevojës për mbrojtjen e shërbimit të ri nga infiltrimi ose ndikimi i paligjshëm, qoftë politik, kriminal ose i ndonjë natyre tjetër;
- të merren hapa për krijimin e besimit publik në ShSK dhe për përfshirjen e parlamentarëve, shoqërisë civile dhe publikut të gjerë në një debat të hapur se si këto probleme të vështira mund të kalohen.

Raporti është në dispozicion në Gjuhën Angleze, Shqipe dhe Serbe në faqen e internetit të VendiSigurtë:

<http://tinyurl.com/36fyud>

Shënime mbi *Të kuptuarit e Shërbimeve informative* gjithashtu janë në dispozicion në faqen e internetit të VendiSigurtë:
<http://tinyurl.com/23xsup>

FUND

Forumi i Iniciativës Qytetare (FIQ) dhe **Saferworld** janë implementues të përbashkët të projektit VendiSigurtë, një program puna e të cilit është e përqendruar në përkrahjen e zhvillimit të një sektori efikas të sigurisë, të përgjegjshëm dhe të ndjeshëm ndaj konfliktit në Kosovë.

Saferworld (www.saferworld.org.uk) është një organizatë e pavarur joqeveritare e cila punon në parandalimin e dhunës së armatosur.

FIQ (www.fiq-fci.org) është një organizatë joqeveritare dhe joprofitabile e cila punon në integrimin e qytetarëve të Kosovës në proceset shoqërore dhe të marrjes së vendimeve, nëpërmes programeve të krijuara për t'u përqendruar në vlerat dhe funksionimin e një shoqërie të hapur dhe demokratike.

Për më shumë informata, ju lutemi kontaktoni:

Ferdinand Nikolla, FIQ, Prishtinë

Tel: +381 (0)38-248-677; Mob: +377 (0)44-171-845

Jérôme Mellon, Saferworld, Prishtinë

Tel: +381 (0)38-248-677; Mob: +377 (0)44-649-682

Virginie Giarmana, Saferworld, Bruksel

Tel: +32 (0)2-230-08-28; Mob: +32 (0)475-35-72-76

Sonia Rai, Saferworld, Londër

Tel: + 44 (0)20-7324-4646; Mob: +44 (0)79-3134-0733